



Npi – 01/04 datë: 03.01.2026

Duke u bazuar në nenin 44 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores së Punës të Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/155 të datës 27.04.2023, për vazhdimin e mbledhjes së Jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Shtimes e mbajtur më 03.01.2026, është nxjerrë:

E K S T R A K T P R O C E S V E R B A L

I Vazhdimit të Mbledhjes së Jashtëzakonshme, të Kuvendit të Komunës së Shtimes, e mbajtur më datën 03.01.2026 (e mërkurë), në ora 14:00h, në sallën e Kuvendit.

Vazhdimin e mbledhjes e hapi anëtari më i vjetër i Kuvendit z.Haqif Arifi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, Konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi i Mbledhjes z.Haqif Arifi, anëtarët e Kuvendit: z.Adnan Ademi, z.Grejtalb Emini, z.Besnik Seferi, z.Halil Kurtishi, z.Zenel Shabani, znj.Yllkë Fejzullahu, znj.Uskana Deliu, znj.Adelina Shabani z.Rahman Jakupi, z.Demokrat Mujota, z.Faik Ramadani, znj.Albana Podvorica, znj.Fatlinda Rrafshi, znj.Arbresha Syla, z.Bajram Hajrizi, z.Shefqet Krasniqi, znj.Frosina Berisha-Ahmeti, znj.Erza Salija, z.Atdhe Isufi, z.Muhamet Ademaj. Përveç anëtarëve të Kuvendit në mbledhje kanë marrë pjesë edhe Kryetari i Komunës z.Qemajl Aliu; Drejtorët: z.Imri Hoxha, DAP; z.Bardhyl Rushiti, DSHP; znj.Mimoza Salihu-Qeriqi DSHMS; Asistentja e Nënkryetarit znj.Gentiana Mehmeti; Zyrtarë i IT-së, z.Shpëtim Gashi; Praktikanti, z.Albion Shabani, si dhe qytetarë të tjerë. Në vazhdim Kryesuesi i mbledhjes z.Haqif Arifi e njoftoi Kuvendin me pikën e dytë të rendit të ditës si vijon:

REND DITE

2. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Shtimes.

Kryesuesi i mbledhjes: z.Haqif Arifi: Përshëndetje për të gjithë. Siç e dini me 31 dhjetor 2025 e kemi pasur mbledhjen e Jashtëzakonshme të thirrur nga Kryetari z.Qemaj Aliu, të përgatitur me dy pika të rendit të ditës. Pika e parë siç e dini ka qenë Betimit i kandidatit nga PDK-ja z.Bajram Hajrizi, ndërsa pika e dytë është zgjedhja e Kryesuesit, kjo pikë është propozuar që të shtyhet dhe pas hedhjes në votim me shumicën dërmuese të votave është vendosur që mbledhja të thirret sot më datë 03.01.2026. Ne jemi të vetëdijshëm që Kuvendi Komunal pa institucione nuk është funksional. Meqenëse Kuorum ka ne po fillojmë me pikën e dytë të rendit të ditës që ka mbetur me u vazhdu për sot. Para se të jepni propozimet e juaja për kandidatin për Kryesues të Kuvendit fillimisht si subjekte politike është e nevojshme që të zgjidhet Komisioni Votues. Kërkojë nga subjektet politike që të japin propozimet e tyre për anëtarë të Komisionit Votues.

z.Adnan Ademi: Përshëndetje. Ne si grup parlamentar i LVV-së propozojmë znj.Adelina Shabani si anëtare të Komisionit Votues.

z.Demokrat Mujota: Përshëndetje. Ne e propozojmë z.Bajram Hajrizin si anëtarë të Komisionit Votues.

z.Shefqet Krasniqi: Përshëndetje. Në emër të grupit parlamentar të LDK-së e propozojmë znj.Frosina Berisha - Ahmeti si anëtare të Komisionit Votues.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht miratoi vendimin për zgjedhjen e Komisionit Votues për përcjelljen dhe numërimin e votave për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Shtimes, në këtë përbërje:**

1. **znj. Adelina Shabani - LVV,**
2. **z. Bajram Hajrizi - PDK,**
3. **znj. Frosina Berisha Ahmeti – LDK.**

Kryesuesi i mbledhjes: z.Haqif Arifi: Të gjithë kandidatët e propozuar për anëtarë të Komisionit të marrin vendin e tyre. Në vazhdim kërkojë nga subjektet politike që të japin propozimet e tyre për Kandidat për Kryesues të Kuvendit të Komunës së Shtimes.

z.Adnan Ademi: Faleminderit edhe njëherë. Kam knaqësinë që në emër të gjithë asambleistëve të LVV-së t'a propozojë kandidate për Kryesuese të Kuvendit, znj.Yllkë Fejzullahu, aktivisten tonë të palodhshme që nga fillimi, asambleistën e parë nga Lëvizja Vetëvendosje, Magjistër e Drejtësisë, Kryetaren e grave për Lëvizjen Vetëvendosje në Shtime, Drejtoreshë e Arsimit në Komunën tonë, shumë e suksesshme. Kërkojë që znj.Yllka Fejzullahu të votohet e sidomos nga gratë sepse mendojë që do t'a përfaqësojë denjësisht Kuvendin e Komunës së Shtimes.

znj.Albana Potvorica: Pëshëndetje. Në emër të PDK-së e propozojmë Kryetarin e degës së PDK-së z.Rrahman Jakupi si kandidatë për Kryesues të Kuvendit. Rrahman Jakupi është kandidat për doktoraturë në fushën e sigurisë, ka një përvojë të gjatë institucionale duke shërbyer, si ish-Nënkryetar i Komunës, ish-Kryesues i Kuvendit, dhe ish-Zyrtarë për Informim Publik ku përvoja integriteti dhe angazhimi i tij e bëjnë një kandidat të denjë për këtë funksion institucional.

z.Shefqet Krasniqi: Përhëndetje. LDK-ja nuk e ka as një emër për kandidat sot. Por më lejoni që t'a bëjë një sqarim për qytetarët e Shtimes. Qytetarë të nderuar sot para jush e ndjej si obligim politik dhe moral që të themë një të vërtetë. Seanca e kaluar me propozimin e LVV-së është shtyer për sot për ndonjë marrëveshje të mundshme me LDK-në. Haptas janë thënë shumë të pavërteta, janë keqinformuar se kinse LDK-ja ka kërkuar nga LVV-ja Nënkryetarin, ka kërkuar 5-6 Drejtori, Kryesuesin etj. Qytetarë të nderuar e vërteta është kjo LDK-ja asnjëherë deri mbërmë rreth orës 21:00h nuk ka pasur ndonjë ftesë zyrtare qoftë nga LVV-ja, qoftë nga Kryetari apo ndonjë thirrje telefonike për të bashkëpunuar. Ne si LDK kemi plan të gatshëm për të bashkëpunuar si dhe bashkëvepruar me secilën parti vetëm e vetëm për të i dërguar proceset përpara. Dhe kjo është e vërteta. Dje rreth orës 21:00 gjatë takimit, ofertë e LVV-së ka qenë dy Drejtori mandje për ato Drejtori është thënë se jo të emërohen Drejtorë të cilët kanë qenë në Legjislaturën e kaluar. Kjo është e vërteta, megjithatë LDK-ja është parti institucionale dhe jemi të obliguar moralisht dhe ndershmërisht dhe për hirë të gjakut të derdhur të Dëshmorëve që të mos jetë asnjëherë bllokuese e Kuvendit as në nivel qendror. Ne jemi për të i dërguar proceset përpara dhe për të punuar për të mirën e qytetarëve. Sot do të votojmë dhe besoj që do të zgjidhen strukturat e Kuvendit.

z.Muhamet Ademaj: Përhëndetje. Pas zgjedhjes së Kryesuesit është e rëndësishme që të angazhohemi që të gjithë për unitet dhe bashkëpunim. Roli i Kryesuesit duhet të jetë unifikues duke respektuar çdo vendim, vetëm të bashkuar mund të ecim përpara dhe do të arrijmë qëllimet tona. Unë si kandidatë i pavarur nuk kam kandidatë për të propozuar.

z.Adnan Ademi: Realisht duke e ditur rregulloren e punës së Kuvendit, sot lejohen vetëm propozime dhe jo fjalime. Megjithatë LVV-ja me LDK-në ka filluar negociatat zyrtarisht e formalisht, e jo formalisht dhe i kam lutë që me bërë më të mirën të mundshme e që me qenë në bashkëqeverisje. Por si duket ose është ky një fjalim i kolegut me tendencë ose është i pa

informuar. Unë i kam të gjitha shkresat në rrjetet sociale. Dhe nëse kolegu nuk e dinë unë do të ja tregojë pas seancës. Ne kemi ardhur në përfundim mbrëmë në takimin e fundit me kërkesë të tij dhe të LDK-së që të flasim për çështjen përfundimtare dhe realisht nuk kemi arritur me bërë atë që kemi dëshiruar deri mbrëmë. Kështu që nuk po du me thënë që është e pavërtetë por sa për informacion për qytetarët, e që shumica e njerëzve e dinë. E dinë edhe shumica e njerëzve të LDK-së, po ashtu edhe shumica e familjarëve të asambleistave që janë tashmë të zgjedhur, e dinë edhe Nënkryetari e Kryetari i LDK-së. Kështu që nëse ne nuk kemi arritur me pas një marrëveshje për me votuar bashkë nuk do të thotë që ne nuk kemi pasur takime zyrtare e jo zyrtare. Edhe njëherë po e them për fund sot nuk jemi këtu me bërë diskutime por me zgjedhë Kryesuesin me votu dhe realisht ajo duhet të ndodhë. Çështje tjera që kanë shkuar nuk do të thotë që nuk mund të vazhdojnë prapë por megjithatë jemi në fazën e fundit, në limitet e fundit ku duhet të konstituohet Kuvendi sot të zgjidhet Kryesuesi, cili është më i miri ju do t'a vendosni për të ardhmen e Kuvendit e pastaj ditëve në vijim e shohmi se si keni me reflektu ne bashkë me juve pa dallime politike, por me i dërguar proceset në të mirën e qytetarëve përpara.

z.Shefqet Krasniqi: I nderuari z.Ademi, me gjithë respektin për të gjithë ju mirëpo Shefqet Krasniqi nuk thotë të pavërteta dhe nuk kam tendenca. Tendecat e mija dhe të LDK-së janë që ky Kuvend të mbahet mend për punë të mira dhe të gjithë së bashku të ecim më tutje sepse në fund të fundit qytetarët e kanë dhënë besimin për të bërë punë të mira. Do të doja që ky Kuvend të emërohet si koshere bletash, dhe bletat të jenë këta djemë dhe këto vajza të mrekullueshme që puna jonë 4 vjeqare të jep një produkt për punët e tona të mira, për një infrastrukturë të mirë dhe unike në zhvillimin ekonomik, arsimor, shëndetësor e të gjitha. LDK-ja është shumë e interesuar që proceset të shkojnë sa më mirë dhe sa më mbarë.

Kryesuesi i mbledhjes: z.Haqif Arifi: E lus Sekretarinë e Kuvendit që të bëjë gati materialin. Kemi ardhur në momentin e votimit, ne paraprakisht e formuam Komisionin Votues, ku detyrë e tij është që ta udhëheqë procesin e votimit. Le të fillojë punën Komisioni Votues.

znj.Frosina Berisha-Ahmeti: Siç e tha edhe Kryesuesi vazhdojmë duke ju thirrur me radhë secilin nga anëtarët e Kuvendit për me marrë fletëvotimin dhe me votuar.

Kryesuesi i mbledhjes: z.Haqif Arifi: Komision i nderuar njëri nga ju i lexon dhe i ndanë fletëvotimet kandidatit e parë dhe të dytin.

z.Bajram Hajrizi: Gjithsej janë 21 anëtarë që kanë votuar, dhe gjithsej janë 21 fletëvotime. Vazhdojmë tash me i nda fletëvotimet të vlefshme dhe të pa vlefshme, duke i numëruar me radhë për të dy kandidatët veq e veq.

Kandidatët: Yllkë Fejzuallahu //////////(9), Rahman Jakupi //////////(12).

Kryesuesi i mbledhjes: z.Haqif Arifi: Konstatoj kuorumin prej 21 anëtarëve prezent në mbledhje.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes në vazhdimin e mbledhjes së Jashtëzakonshme, të mbajtur më datën 03.01.2026, (bazuar në votat e numruara nga Komisioni Votues) me 12 vota "Për", me 9 vota "Kundër" dhe me 0 vota "Abstenim" miratoi Vendimin për zgjedhjen e z.Rahman Jakupi - Shtime, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Shtimes.**

Kryesuesi i mbledhjes: z.Haqif Arifi: Urime, dhe urojë të jesh një Kryesues unifikues, që dinë se çka bënë, që punon bashkë në të mirën e qytetarëve tonë dhe nuk bënë dallime, që bashkëpunon dhe vepron. E keni fjalën.

z.Rahman Jakupi: Përsëritet. Sot me përgjegjësi institucionale e pranoj këtë besim që më është dhënë për të ushtruar detyrën e Kryesuesit të Komunës nga të gjithë ju anëtarë që jeni prezent këtu në sallë. I falenderojë të gjithë anëtarët e Kuvendit pa dallim për mbështetjen dhe besimin që më është dhënë. Ky besim nuk është fitore personale apo politike por është detyrim

që me shërbyer për Komunën e Shtimes, për të ruajtur integritetin e Kuvendit të Komunës dhe për të garantuar funksionimin demokratik në përputhje me ligjet dhe interesin e qytetarëve të Komunës së Shtimes. Respektoj qëndrimin politik të atyre që nuk më votuan sot por le t'a kuptojnë të gjithë që Kuvendi i Komunës është shtëpi e debatit demokratik dhe zëri i secilit anëtarë që unë si Kryesues i Kuvendit të Komunës së Shtimes do t'a trajtojë me respekt dhe me korrektësi. Falenderim i veçantë shkonë për të gjithë qytetarët e Komunës së Shtimes. Faleminderit ish-Kryesuesit z.Arifi për këshillen dhe rekomandimin që dhatë mirëpo me këtë moment unë sigurojë që do të jam Kryesues i të gjithëve dhe jo i një grupi apo subjekti të caktuar politik, për shkakë që e di se çfarë përgjegjësie ju si anëtarë të Kuvendit më keni dhënë. Tani e mbyllë këtë seancë duke ju falenderuar edhe njëherë për besimin dhe do të bashkëpunojmë bashkarisht për të i udhëhequr dhe për të dërguar interesin e qytetarëve të Shtimes përpara.

Mbledhja ka përfunduar në ora 15.10h

Procesmbajtëse
Sadberë Halili

Sadberë Halili



Kryesuesi i Mbledhjes
Haqif Arifi

Haqif Arifi